



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.69/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës- PDK, me seli në Prishtinë, Pleurat Sejdiu, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.01.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.69/2025 e datës 17.01.2025

II. Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 4,000.00 (katërmijë) euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 18.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se Kandidati për deputet nga radhët e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Pleurat Sejdiu, momentalisht kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës, ka postuar një video në llogarinë e tij në Facebook një video me tekst shoqërues, të realizuar në hapësirën e brendshme të Odës së Mjekëve të Kosovës, në kundërshtim me dispozitat ligjore zgjedhore, duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale, duke bërë edhe thirrje që të votohet numri i tij dhe subjektit përkatës.

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se me anë të këtij veprimi, janë shkelur dispozitat ligjore të nenit 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP.

Si provë ka bashkangjitur Fotografi dhe videopostimin në facebook, fotografi dhe video në link. <https://www.facebook.com/reel/573969635627270>

Më datë 19.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partia Demokratike e Kosovës për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 20.01.2025.

Në përgjigjen në ankesë të datës 20.01.2025, të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e kundërshtojnë në tërësi ankesën e parashtruar nga LVV, për shkak se veprimi i kandidatit për deputet Dr. Pleurat Sejdiu momentalisht kryetar i Odes se Mjekëve të Kosovës, se siç mund të vërehet nga provat e bashkangjitura në ankesë se i njëjti të ketë përdorur pasurin apo zyrën si person qe mbanë pozitën publike, në qendër dhe në vëmendje të kësaj video është prezantimi i kandidaturës së tij dhe vizioni i tij për legjislaturën e ardhshme dhe se zyra/ambienti ku është realizuar videoja fare nuk ndërlidhet me qëllimin për përfitime te votave, i njëjti nuk ka promovuar asnjë nga pasurit e zyrës , dhe se i njëjti këtë pasuri ta ketë përdorur me qëllim të përfitimit te votave. Një video e tillë do të mund të realizohej në çfarëdo ambienti dhe se qëllimi për përfitim te votave, nuk ka qenë si derivat për përdorim të zyrës apo ndonjë pasurie të zyrës ku i njëjti mbanë pozitën publike. Në vazhdim të përgjigjes thuhet se z. Pleurat Sejdiu me veprimet e tij nuk e ka përdorur zyrën apo ndonjë nga pasurit e te qenurit person publik për faktin vetëm se ka realizuar një video në këtë ambient dhe se ne asnjë mënyrë nuk përbën përdorim të zyrës apo të ndonjë pasurie të saj , e cila nuk përbënte ndonjë shkelje te nenit 36, paragrafi 1 te Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Andaj ankuesi me pretendimet e përmendura nuk ka arritur me asnjë prove të vërtetoj faktin e pakontestueshëm qe kjo video te jete realizuar ne zyrën e tij ku mban pozitë publike, mirëpo për shkak të afatit te kufizuar për parashtrimin e përgjigjes në ankesë , ka qenë e pamundur që të behet verifikimi nëse zyra në të cilën është realizuar video është në zyret e personit i cili mban pozitë publike, z. Pleurat Sejdiu. Po ashtu edhe nëse e marrim si te mirëqenë faktin se video është realizuar ne zyrën e Pleurat Sejdiut i cili mban pozit publike, vlersojm se realizimi i videove (pa shfrytëzuar pasurit e kësaj zyre, logon si dhe asetet tjera), në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se ambientin e zyrës nuk e ka përdorur për realizimin e takimeve partiake dhe se nuk ka shfrytëzuar asnjë pasuri te saj me qëllim te përfitim te votave dhe se një veprim i tillë në asnjë mënyrë nuk përbën shkelje të nenit 36 par.1, i Ligjit Nr.08/ L-228 të LZP-së.

Në vazhdim të përgjigjes theksojnë se deputeti z. Pleurat Sejdiu me veprimin e tij në asnjë mënyrë nuk ka bere shkelje te përcaktuara ne Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, dhe Reklamimin Financiar si dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme ashtu siç u argumentua më lart se veprimet e tij nuk përbejnë përdorim te zyrës apo pasurisë se fituar si person i cili mban pozit publike.

PZAP-i, ka gjetur se:

Ankesa është bazuar

Paneli pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i videos është ende aktiv në llogarinë e facebook-ut të kandidatit për deputet nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Pleurat Sejdiu dhe ka vërtetuar se njëjta është bërë në zyrën në Odës së mjekëve të Kosovës. Nga prova materiale e bashkangjitur ankesës, së Subjektit Politik LVV, dhe shkresave tjera të lëndës, paneli ka vlerësuar se nga ana e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës, është shkelur Rregulla Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që kandidati në fjalë, me qëllim të promovimit të kandidaturës së tij për deputet, është regjistruar në ambientet e Odës së Mjekëve të Kosovës, për fushatë zgjedhore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par.1, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “ *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë at zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave*”.

Sipas përgjigjes së dhënë në ankesë pretendohet se kjo video është prezantimi i kandidaturës së tij dhe se zyra/ambienti ku është realizuar videoja fare nuk ndërlidhet me qëllimin për përfitime të votave, i njëjti nuk ka promovuar asnjë nga pasuritë e zyrës, dhe se i njëjti këtë pasuri ta ketë përdorur me qëllim të përfitimit të votave. Një video e tillë do të mund të realizohej në çfarëdo ambienti dhe se qëllimi për përfitim të votave, nuk ka qenë si derivat për përdorim të zyrës apo ndonjë pasurie të zyrës ku i njëjti mbanë pozitën publike

Sipas vlerësimit të panelit konkludohet se kjo video është bërë në ambientet e Odes Mjkeve të Kosovës, pasi që gjatë prezantimit shihen simbole identifikuese të OMK, është bërë gjatë fushatës zgjedhore dhe kjo video është bërë me qëllim të përfitimit të votave.

Rrjedhimisht sipas vlerësimit të panelit veprimet e kandidatit për deputetet Pleurat Sejdiu, bie ndesh me dispozitën e nenit 36 paragrafi 1 të LZP-së dhe rregullës zgjedhore 07/2024..

Kështu që paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben shkelje të legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në subjekti politik PDK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja e videos për fushatë zgjedhore në ambiente të institucionit, në këtë rast në zyrë në Odën e Mjekëve të Kosovës, e që përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet për afërsisht të ngjashme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.69/2025 më datën 20.01.2025

Kryesuese i Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.